



GSRM

KOMISIONE TË APLIKUARA NGA NDËRMJETËSIT FINANCIAR

Material Infomues

INFORMACION PËR VEPRIMET ME LETRAT ME VLERË

TË TREGTUARA NGA FIBANK

Fibank e licensuar si një “Shoqëri brokerimi (broker -dealer) në letrat me vlerë të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë në Bursë dhe në tregun me pakicë” ushtron veprimtarinë e tregtimit të titujve (blerje/shitje) nëpërmjet marrjes dhe ekzekutimit të urdhërave (porosive) të klienteve.

1. Fibank ofron mundësinë e pjesëmarrjes së individëve dhe jo individëve në ankandet e tregut primar të Bonove dhe Obligacioneve të Thesarit (organizuar nga Banka e Shqipërisë) nëpërmjet të gjitha sporteleve të bankës.

Komisioni i aplikuar nga Fibank për të vepruar në rolin e ndërmjetësit në ankand është 0.15% e vlerës nominale, minimumi ALL 1,000, maksimumi ALL 3,000.

2. Fibank tregton Bono Thesari nga disa ankande me afate maturimi të ndryshme. Tregëtimi i Bonos së Thesarit mund të bëhet deri në 7 ditë para maturimit.

- a) Fibank blen Bono Thesari të cilat mund të jenë shitur në ankandet e tregut primar, nga portofoli i Fibank , ose nga portofoli i një banke tjetër të licensuar nga AMF si broker.

Kur klienti blen Bono të Thesarit nga portofoli i tregtueshëm i bankës, Fibank nuk aplikon asnjë komision. Në këtë rast klienti do të paguajë shumën në bazë të çmimit të shitjes së kuotuar nga banka dhe ditëve të mbetura deri në maturim.

Shembull:

Një klient dëshiron të blejë një Bono Thesari në një shumë LEK 1,000,000 nga portofoli i Fibank të cilës i kanë mbetur 273 ditë deri në maturim. Yield-i i shitjes nga Fibank është 6.60%.

$$\text{Çmimi i shitjes} = 1,000,000 * C / (6.60 + C)$$

$$C - \text{konstante e cila llogaritet } 365 * 100 / 273$$

$$\text{Çmimi} = (1,000,000 * 133.7) / (6.60 + 133.7) = 952,957.82$$

- b) Fibank shet Bono Thesari me vlerë minimale 300.000 lek dhe shtohet me shumëfisha të 10,000.00 lekë. Interesi i fituar nga Bonot tërhiqet në çdo kohë, duke filluar nga data e investimit deri në datën e maturimit.

Kur klienti shet Bono të Thesarit para datës së maturimit pranë sporteleve të Fibank nuk aplikohet asnjë komision. Në këtë rast klientit i llogaritet çmimi në bazë të yield-it të blerjes nga banka dhe ditëve të mbetura deri në maturim.

Çmimet/kuotimet e Bonove të Thesarit luhaten në varësi të situatës së likuiditetit në treg.

Shembull:

Një klient dëshiron të shesë një Bono Thesari në një shumë LEK 1,000,000 nga portofoli i Fibank të cilës i kanë mbetur 105 ditë deri në maturim. Yield-i i shitjes nga Fibank është 7.0%.

Çmimi i blerjes = $1,000,000 * C / (7.0 + C)$

C - konstante e cila llogaritet $365 * 100 / 105$

Çmimi = $(1,000,000 * 348) / (7.0 + 348) = 980,260.5$

3. Fibank tregton Obligacione Thesari të shitura në ankandet e tregut primar, të shitura prej portofolit të saj ose të një banke tjetër të licensuar si broker. Për të kryer këtë transaksion, duhet që Obligacioni të ketë të pakten 7 ditë të mbetura deri në maturim.

Fibank shet Obligacione Thesari nga disa ankande me maturime të ndryshme. Për këtë shërbim nuk merret komision.

Obligacionet e thesarit shiten me premium/discount ndaj vlerës së tyre nominale. Investitori në ditën e blerjes paguan vetëm çmimin e blerjes në përputhje me vlerën nominale dhe normën Yield-in, i cili përcaktohet nga banka.

Kuotimet e Obligacioneve të thesarit luhaten në varesi të tregut.